



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,
në Riga Technical University, Letoni**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Riga Technical University – RTU.

Llojet e mobilitetit për studentët përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik).
- **Master** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave për studentët: 1 semestër, (Semestri i parë, i vitit akademik 2026-2027).

Fushat e studimit për studentët: Të gjitha degët. (Studentët e interesuar të shohin lëndët që ofrohen nga RTU, sipas fakulteteve përkatëse, në linkun: [Course List for Exchange Studies - Google Sheets](#))

Numri total i studentëve: 2 studentë (Numri përfundimtar i studentëve të nominuar përcaktohet nga RTU.)

Përparësi në nominimin e studentëve, si dhe për aspektin financiar gjatë mobilitetit kanë studentët që u përkasin grupeve të disavantazuara. (Studentë, prindërit e të cilëve kanë vdekur në krye të detyrës; studentë me ndihmë financiare; studentë me nevoja të veçanta; studentë prindërit e të cilëve kanë nevoja të veçanta, studentë që kanë marrë statusin e jetimit; studentë që kanë qenë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore; studentë të grupeve etnike; studentë, prindërit e të cilëve ishin të dënuar të regjimit komunist; studentë, prindërit e të cilëve janë në pension etj.)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

- Dokumenti Learning Agreement**.

Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është **B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në RTU lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

- Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni: [learning-agreement](#) (for students from non-EU countries)

Për t’u njohur me lëndët që ofrohen në RTU, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-un: [Course List for Exchange Studies - Google Sheets](#)

Afati për aplikim për studentët: Deri më 20 Mars 2026, ora 12.00

Aplikimi për studentët kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al